



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS

**Drejtuar:** Operatorin ekonomik “SHPRESA - AL” shpk

**Adresa:** Tirane, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:**“Procedurë e Hapur”, me Marreveshje Kuader, Loti XV: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Mbrojtja e Digës Liqeni Çekrezë”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:**Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Mbrojtja e Digës Liqeni Çekrezë”.

**2. Numri i referencës së procedurës/lotit:REF:42177-09-19-2022**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Fondi limit per Lotin XV:44,931,335**(dyzet e katër milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:***me burim financimi*Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit”, miratuar me VKB Nr. 49, datë 14.06.2022 “Për disa ndryshime në VKB Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022 (e ndryshuar)”

**Kohëzgjatja e kontratës:**12 (dymbëdhjetë) javë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:05.10.2022, ora 10:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.131 datë 26.09.2022.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “NIKA & NDETRUESI 2014” shpk**

**NUIS J76705047U &NUIS L46827004L**

Vlera e ofertës = **33,040,578.20**(tridhjetë e tre milion e dyzet mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë pesë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “CURRI” shpk**

**NUIS J67902718S**

Vlera e ofertës = **33,965,922**(tridhjetë e tre milion e nëntëqind e gjahtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk**

**NUIS K71412003A**

Vlera e ofertës = **39,455,035**(tridhjetë e nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk & “ED KONSTRUKSION” shpk**

**NUIS K51423028P&NUIS K61625001I**

Vlera e ofertës = **39,004,441**(tridhjetë e nëntë milion e katër mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “ARB & TRANS-2010” shpk & “EVEREST” shpk& “INERTI” shpk**

**NUIS L02325001T&NUIS J78311921L&NUIS J66926804L**

Vlera e ofertës = **39,082,019.90**(tridhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “SHPRESA - AL” shpk**

**NUIS K31321021N**

Vlera e ofertës:**39,984,079** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

## 1. Operatori ekonomik “NIKA & NDETRUESI 2014” shpk

- Operatori Ekonomik NDETRUESI 2014 shpk, nuk ploteson DST, Kriteret e vecanta, pika 2.3 Kapacitetin Teknik, pika 1, ku citohet se: pika 1/a “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 22,465,667.5 (njezet e dy milion e katerqind e gjashtedhjetë e pese mijë e gjashteqind e gjashtedhjetë e shtate pike pese) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” si dhe pika 1/b “Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 89,862,670 (tetedhjetë e nente milion e teteqind e gjashtedhjetë e dy mijë e gjashteqind e shtatedhjetë) lekë pa TVSH. Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Operatori ekonomik NDETRUESI 2014, ka paraqitur si pune të ngjashme kontratat: “Rikonstruksion Rruga Bardhaj...” me vlerë sipas % të BOE ka punime me vlerë 2,080,782.2 leke pa tvsh”, Sistemim –Asfaltim Rruga Pentar i Poshtem, me vlerë 5,267,716 pa TVSH, Sistemim-Asfaltim Rruga.....Fshati Trush”, me vlerë 5,975,160 si dhe Mbrojtje Argjinatura Lezhe”, me vlerë sipas % të BOE 7,320,510 leke pa TVSH, ndersa kontrata e paraqitur me objekt “Rikonstruksion i kabinave eklektrike...”, nuk është sipas objektit të prokurimit. Pas verifikimit rezultoi se operatori ekonomik NDETRUESI 2014 shpk, nuk ka plotësuar punët e ngjashme në raport me % e punëve të marra për sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit konkretisht 39.01 % të punimeve, pasi kontratat e paraqitura nuk plotësojnë asnjë nga pikat e mesipërme as në një kontratë të vetme dhe as me disa kontrata gjashtë 5 viteve të fundit.

- Bilancet e paraqitura nga operatori ekonomik NDETRUESI 2014 shpk, *nuk janë të audituara nga Auditues i Licensuar të kerkuar në DST, Kapacitetet Ekonomike e Financiare, pika 1, paragrafi shemin: “Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Pas verifikimit rezultoi se OENdertuesi 2014 shpk, ka Xhiro vjetore mbi 100 mln leke, ka totalin e aktiveve mbi 50 mln leke si dhe numeri mesatar i punonjësve është mbi 30 punonjës.*
- Vlera e përcaktuar në ndarjen e punimeve të detajuara sipas zerave të kerkuar në DST, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit date 05.10.2022, nuk është sipas preventivit të paraqitur, konkretisht vlera totale e preventivit (ofertes) është 33,040,578.2 leke pa TVSH ndersa tek tabela bashkelidhur marrëveshjes së bashkëpunimit date 05.10.2022 është 33,682,142.81 leke pa TVSH, cka bie ndesh me DST.
- Marita Tauzi, e deklaruar në Shtojcën 8 nga operatori ekonomik NIKA shpk, si Përgjegjës për sigurinë e shëndetit në punë si dhe përgjegjës për demet në mjedis,

nuk është deklaruar profesioni, pasi në DST, pika 7, ku citohet se: "Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjes inxhinier si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", (i ndryshuar)", pasi pas verifikimeve rezultoi se OE Nika shpk ka deklaruar ing. Mjedisi, në shtojcën 8.

## 2. Operatori ekonomik "CURRI" shpk

- Referuar Shtojcës 8, Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit pika 6 dhe 7, rezultojnë se Operatori ekonomik "CURRI" shpk i ka plotësuar gabim përgjigjet, çka bie në kundërshtim me DST.
- Referuar Shtojcës 8, Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, rezultojnë se Operatori ekonomik CURRI shpk, nuk ka deklaruar 6 (gjashtë) manovratorët, për të cilin bie në kundërshtim me pikën 10, të DST, të Kapacitetit teknik: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës manovrator, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)".
- Referuar Shtojcës 8, Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, rezultojnë se Operatori ekonomik CURRI shpk, nuk ka deklaruar listën emerore për punonjësit 2 (dy) saldator për të cilin bie në kundërshtim me pikën 10, të DST, të Kapacitetit teknik: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: 2 (dy) punonjës saldatorë".

## 3. Operatori ekonomik "KLAJGER KONSTRUKSION" shpk & "ED KONSTRUKSION" shpk

- Operatori Ekonomik ED Konstruksion nuk ka deklaruar në Shtojcën 8, "**Përgjegjës për dëmet në mjedis**", kerkuar në DST, pika 7, ku citohet se: "Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjes inxhinier si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", (i ndryshuar), shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate lëshuar nga autoritetet të akredituara përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për dëmet në mjedis").
- OE Klajger Konstruksion nuk ka deklaruar në Shtojcën 8, "**Përgjegjës për dëmet në mjedis**", kerkuar në DST, pika 7, ku citohet se: "Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjes inxhinier si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë

09.6.2011“Për mbrojtjen e mjedisit”, (i ndryshuar), shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga autoritetet te akredituara pergjegjese shteterore, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për dëmet në mjedis").

- Operatori Ekonomik KLAJGER KONSTRUKSION shpk & ED KONSTRUKSION shpk, **nuk plotesojne Kapacitetin Teknik, pika 15, Fadrome me Goma 2 (dy) cope.** Pas verifikimit rezultoi se OE Klajger Konstruksion shpk ka deklaruar ne shtojcen 8, 2 (dy) fadrome me goma ( sipas fatures Nr.71, date 04.07.2019 dhe fatures Nr.25, date 18.10.2020, por nuk ka deklaruar dokumentacionin perkates ne formularin e vetdeklarimit si (targa, leje e qerkullimit etj), cka bie ne kundërshtim me DST, pika 15, shkronja a, ndërsa OE Ed Konstruksion shpk ka deklaruar vetem nje fadrome me goma, e per pasoje nuk plotesohet kerkesat e percaktuar ne DST pika 15 nga Operatori Ekonomik KLAJGER KONSTRUKSION shpk & ED KONSTRUKSION shpk, mbi disponimin e dy mjeteve Fadrome me Goma.

#### **4. Operatori ekonomik “ARB & TRANS-2010” shpk & “EVEREST” shpk& “INERTI” shpk**

- Operatori Ekonomik ARB & TRANS-2010 shpk, nuk ploteson DST, Kriteret e vecanta, pika 2.3 Kapacitetin Teknik, pika 1, ku citohet se: “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 22,465,667.5 (njetet e dy milion e katerqind e gjashtedhjetë e pese mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e shtate pike pese) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates” si dhe “Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 89,862,670 (tetedhjetë e nente milion e teteqind e gjashtedhjetë e dy mije e gjashteqind e shtatedhjetë) lekë pa TVSH, pasi pas verifikimeve te kontratave te paraqitura konkretisht: “Rruga Konferenca e Mukjes”, “Rruga Muhamet Deliu”, “Rrjeti shpernadares Qenam...”, nuk eshte e shoqeruar me akt marrje ne dorezim te punimeve, ndërsa per kontraten “Ndertim Rrjeti Ujesjellesi.....” (nuk eshte sipas objektit te prokurimit si dhe mungon certifikata e marrjes ne dorezim)”, Kontrata “Shembje e ndertesave ne Zall Herr” (nuk eshte sipas objektit te prokurimit), si dhe Ndertim Shkolla Murat Toptani (nuk eshte sipas objektit te prokurimit). Vetem kontrata ndertim ura, fshatit Vila, Zall Bastar me vlere 6,282,336 leke pa TVSH, ploteson kushtet e percaktuara ne DST por OE Arb&Trans-2010 shpk nuk ploteson punet e ngjashme ne raport me % e puneve te marra persiper sipas Marreveshjes se Bashkepunimit konkretisht 32 % te punimeve, pasi kontratat e paraqitur nukplotesojne asnjeren nga pikat e mesiperme as ne nje kontrate te vetme dhe as me disa kontrata gjate 5 viteve te fundit.
- Operatori Ekonomik ARB & TRANS-2010 shpk & EVEREST&INERTI shpk, nuk plotesojne Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit pasi nuk eshte paraqitur ndarja e punimve mes operatoreve sipas marreveshjes se bashkepunimit, e kerkuar ne DST Kriteret e pergjitheshme ku citohet se: “Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim

Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit”.

- Operatori Ekonomik ARB & TRANS-2010 shpk, ka plotësuar gabim shtojcën 8 Formulari i Vetdeklarimit, pika 3 tek kolona “Deklarate për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhënjet e punës”.
- Operatori Ekonomik ARB & TRANS-2010 shpk, nuk ka plotësuar në shtojcën 8, Formulari i Vetdeklarimit, “që nuk është i denuar me vendim të formsë së prerë” si dhe nuk është plotësuar hapsira mbi ushtrimin e detyrës në zbatim të kërkesave ligjore...”.
- Operatori Ekonomik INERTI shpk, ka plotësuar gabim shtojcën 8 Formulari i Vetdeklarimit, pika 7, pasi në këtë procedurë prokurimi është Bashkim Operatorësh.
- Operatori Ekonomik EVEREST shpk, ka plotësuar gabim shtojcën 8 Formulari i Vetdeklarimit, pika 3 tek kolona “Deklarate për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhënjet e punës”.
- Operatori Ekonomik INERTI shpk, nuk plotëson DST, Kriteret e vecanta, pika 2.3 Kapacitetin Teknik, pika 1, për punët e ngjashme, pasi kontrata e paraqitur është ndërtim pallati, dhe si pasoje nuk është në përputhje me objektin e prokurimit.
- Operatori Ekonomik EVEREST shpk, pas verifikimit të vertetimit të paraitur me Nr. 6134/1 datë 08.09.2022 nga FSHU, rezultoi se OE Everest shpk nuk ka paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin Gusht.
- Operatori Ekonomik EVEREST shpk, nuk plotëson DST, Kriteret e vecanta, pika 2.3 Kapacitetin Teknik, pika 1, për punët e ngjashme, pasi për kontratën e paraqitur me objekt “Rikonstruksion Rruga Toptani”, nuk është paraqitur Certifikata e marrjes në dorezim.

## 5. Operatori ekonomik “BE – IS” shpk

- Deklarata e Drejtuesit Teknik të punimeve, është i plotësuar në mënyrë të pasakte, pasi OE BE-IS shpk deklaroi se Drejtuesi teknik për objektin: **Loti XII: “Mbrojtja Nr. 1 Nga Grryerjet e Lumit Zhullima, Baldushk” (nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, pasi objekti I prokurimit është “Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Mbrojtja e Digës Liqeni Çekrezë”)**, do të jetë z. I K me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë si Drejtues Teknik me vjetërsi pune, i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve në rast se do të shpallemi fitues për këtë procedurë prokurimi dhe se nuk është i angazhuar në kontratë të tjera, çka bien ndesh me DST, pika 3.
- Grafiku i punimeve i paraqitur nga OE BE-IS shpk është i pasakte pasi **nuk është firmosur e vulosur** nga OE BE-IS shpk, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, çka bien ndesh me Kërkesat e DST, Kapaciteti Teknik, pika 13, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 12 (dymbëdhjetë) javë kalendarike”*.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “SHPRESA - AL” shpk**, me adresë: *Tirane, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **39,984,079** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.